

Përgjimi Ligjor i Telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për Sigurinë

Shpend Kursani¹
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Abstrakti

Duke shikuar nga këndvështrimi i një mjedisi të përbërë nga një numër i madh i aktorëve të sigurisë në Kosovë, ky dokument bënë vlerësimin e përgjimit të telekomunikimeve në Kosovë si një masë e ndjeshme hetimi por mjaft efikase në të njëjtën kohë. Dokumenti bënë një shtjellim të detajuar të problemeve të tanishme sa i përket përgjimit të telekomunikimeve e që përfshinë të metat në legjislacionin e tanishëm, përzierjet e përgjegjësive që krijohen si rezultat i pa përcaktimit të qartë të autoritetit mbi ekzekutimin e urdhrave për përgjimin e telekomunikimeve, dhe mungesa e bashkëpunimit jo vetëm midis aktorëve vendorë dhe ndërkombëtar të sigurisë, por edhe i bashkëpunimit përbrenda institucioneve vendore të sigurisë në Kosovë. Duke mos u përkufizuar vetëm në institucionet e sigurisë, ky dokument po ashtu analizon procedurat dhe bashkëpunimin që ekziston midis institucioneve të sigurisë dhe operatorëve të telekomunikacionit si dhe kapacitetet infrastrukturore të tyre të cilat janë të rëndësishme në pengimin e keqpërdorimeve të të dhënave private përgjatë procesit të përgjimit ligjor të telekomunikimeve. Duke u bazuar në objektivat e politikave që parashtrohen, ky dokument jep edhe rekomandimet e politikave të cilat mes tjerash përfshinë përmirësimin e legjislacionit të tanishëm, themelimin e një sistemi qendror që do ta përmirësonte bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve të sigurisë, përmirësimin e mekanizmave të tanishëm si dhe krijimin e mekanizmave të ri për inspektim dhe monitorim. Zbatimi i rekomandimeve në njërën anë do të siguronte një përgjim ligjor më efektiv të telekomunikimeve dhe në anën tjetër do të mundësonte mbrojtjen e intimitetit si e drejtë themelore njerëzore.

Fjalët kryesore: përgjimi ligjor i telekomunikimeve, masat speciale të hetimit, aktorët e sigurisë

¹Shpend Kursani mban titullin Magjistër i Filozofisë në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Kembrixhit (2011) dhe titullin Bachelor i Shkencës në Politika Publike dhe Menaxhment (2007). Kursani është përfshirë në sektorë dhe institucione të ndryshme në Kosovë. Ai ishte i përfshirë në themelimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (2004) dhe ka vazhduar të punoj si konsulent në Management and Development Associates në planifikime strategjike dhe në projekte hulumtuese intensive (2004-2006). Kursani ishte po ashtu i përfshirë në industrinë e telekomunikacionit duke punuar në Ipko Telecommunications si udhëheqës i departamentit për zhvillimin e produkteve (2007-2010). Momentalisht ai është bashkëpunëtor hulumtues në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë, analist kontribues në Wikistrat Global Strategies, dhe ligjërues në Kolegjin Universitar Universum.

Metodologjia

Ky dokument është rezultat i një hulumtimi kualitativ i cili përfshinë disa burime primare dhe sekondare. Sa i përket burimeve primare hulumtimi është bazuar në intervista që janë bërë me zyrtarë dhe ish zyrtarë të lartë në Policinë e Kosovës, zyrtar nga EULEX-i të cilët punojnë në këtë lëmi, dhe nëpunës e ish nëpunës administrativ dhe teknik në operatorët e telekomunikacionit. Në këtë aspekt janë hulumtuar dhe shqyrtuar ligje që kanë të bëjnë me procedurat penale, masat speciale të hetimit, agjencitë e inteligjencës, telekomunikacionet, si dhe rregullore dhe vendime zyrtare të marra nga autoritetet relevante në këtë sektor. Në të njëjtën kohë janë marr parasysh edhe disa burime sekondare nga mediat elektronike dhe të shkruara si dhe dokumentet e shkurtra të politikave dhe raporte hulumtuese të publikuara nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, të cilat kanë ndihmuar në nxjerrjen e disa shembujve në mbështetje të deklaratave dhe argumenteve të dhëna në këtë dokument.

**Për çdo paqartësi që mund të haset në këtë dokument mund ta konsultoni versionin origjinal në gjuhën angleze.*

QKSS dëshiron të falënderoj mbështetjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur – “Think Tank Fund” për mundësimin e hulumtimit dhe publikimit. Përveç kësaj, vlen të theksohet mbështetja e përgjithshme institucionale e “Think Tank Fund” me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve dhe aftësive të hulumtuesve të QKSS-së

LISTA E SHKURTESAVE

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
ART	Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (European Union Rule of Law Mission in Kosovo)
IDS	Institucionet e Drejtësisë dhe Sigurisë
IHSOP	Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinionit Publik
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KPPP	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale
ORrMV	Operator i Rrjetit Mobil Virtual
OShI	Ofrues i Shërbimeve të Internetit
PTK	Posta dhe Telekomuni i Kosovës
SHIK	Shërbimi Informativ i Kosovës
ShVSh	Shërbime me Vlerë të Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (United Nations Mission in Kosovo)
ZAPGj	Zyrtar të Autorizuar të Policisë Gjyqësore

PËRMBAJTJA

1. Përshkrimi i rrethanave	5
2. Problemet, duke filluar nga definicioni	6
3. Kufizimet që aplikohen në përgjimin ligjor të telekomunikimeve.....	7
4. Autoriteti i përzier dhe nevoja për ta përcaktuar (qartë) zotërimin	9
5. Procedurat	11
5.1. Procesi.....	11
5.2. Rastet e ngutshme	12
5.3. Mekanizmat mbrojtës.....	12
5.4. Mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit	13
6. Çështjet që kanë të bëjnë me të Drejtat e Njeriut	14
7. Operatorët e telekomunikacionit	16
8. Një tregim për aktorët nën hije.....	17
9. Objektivat e politikave	18
10. Rekomandimet e politikave.....	19
Bibliografia:	21

1. PËRSHKRIMI I RRETHANAVE

Natyrë dhe mandati i institucioneve të sigurisë në Kosovë kanë ndryshuar disa here përgjatë dekadës së kaluar. Edhe pse mandati për të ofruar shërbime të inteligjencës dhe për të marrë masa speciale të hetimit ka kaluar gradualisht nga aktorët ndërkombëtarë të sigurisë tek ata vendor, kjo veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, përgjimi i telekomunikimeve vazhdon të qëndrojë në errësirë. Ka disa raste kur çështjet që kanë të bëjnë me përgjimin e telekomunikimeve, si dhe të metat në gjithë sistemin, janë bërë publike. Jo shumë kohë më parë, një e metë në sistem ishte vënë re atëherë kur Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) u ankua për faktin që vetëm konsumatorët e PTK-së u ekspozoheshin përgjimit të telekomunikimeve, për shkak të, siç supozohej, refuzimit të operatorit tjetër për t'i lejuar Institucionet e Drejtësisë dhe Sigurisë (IDS-të) që t'i përgjojnë klientët e tyre.² Po ashtu, debatet e ngritura më herët si dhe raportet e shpërndara nëpër lajme të ndryshme lidhur me ekzistencën e strukturave partiake të inteligjencës (sidomos gjatë periudhës së pas luftës) si dhe praninë e shërbimeve të huaja të inteligjencës në Kosovë³ ka ngritur kureshtjen e publikut edhe më shumë.

Publiku i përgjithshëm nuk është i vetmi grup i hutuar në këtë lëmsh. Dyshimi i Ministrit të Brendshëm se po përgjohej nga organet ndërkombëtare në Kosovë, më saktësisht nga ana e EULEX-it, nuk ndihmuan në rrethanat e errëta që ekzistojnë në këtë drejtim si dhe e ngritën gjithë këtë hutim edhe në nivelin institucional. Çka bënë për tu brengosur edhe më shumë është ajo se një dyshim i tillë ngritet nga ana e vet Ministrit të Brendshëm, misioni i të cilit është të ndërtojë dhe të ruajë sigurinë për të gjithë qytetarët në Kosovë. Disa nga aktorët e shoqërisë civile mund ta kishin quajtur dyshimin e ministrit si të pa sinqertë, mirëpo deklarata e ministrit medoemos ka vënë në pikëpyetje zotërimin real të masave speciale të vëzhgimit dhe hetimit në këtë shtet. Një shqetësim tjetër relevant për sigurinë e Kosovës dhe institucionet e saja, i cili vazhdon të mbetet i pafolur, është lidhja e tanishme e interkoneksionit ndërkombëtar të telefonisë fikse, gjegjësisht përdorimit të kodit të Serbisë (+381). Lidhja e tanishme e cila ia mundëson Serbisë që të ketë kontroll të plotë të të gjitha thirrjeve që vinë në Kosovë nga jashtë, paraqet shqetësime edhe më të mëdha për sigurinë kur merret parasysh fakti që marrëdhëniet me Serbinë janë jo funksionale dhe të pa përkufizuara.

Përgjimi i telekomunikimeve mund të konsiderohet si një masë tinëzore, por në të njëjtën kohë ajo është mjaft e fuqishme në atë se ndihmon në identifikimin dhe ndjekjen penale të të dyshuarve në përfshirje në krime të rënda dhe të atyre që kërcënojnë sigurinë kombëtare në përgjithësi. Edhe pse kjo tregon në përgjithësi se për çfarë qëllimesh zakonisht përdoret përgjimi ligjor, kjo masë hetimi në Kosovë përmban disa të meta në nivele të ndryshme. Së pari, legjislacioni përkatës në Kosovë nuk bënë ndonjë dallim të duhur ndërmjet përgjimit të telekomunikimeve dhe masave tjera të hetimit e cila si rrjedhojë pamundëson legjislacionin relevant të limitojë përdorimin e këtyre masave varësisht nga shkalla e krimit dhe efektet e tyre në intimitetin e individëve. Së dyti, mungon përcaktimi i qartë se kush mund të përfshihet në dhënien e urdhrave për përgjimin e telekomunikimeve si dhe mungojnë mekanizmat që rregullojnë bashkëpunimin ndërmjet shumë aktorëve të sigurisë në Kosovë. Kjo si pasojë lejon që të krijohet një përzierje kur jepet urdhri për ekzekutimin e përgjimit të telekomunikimeve e cila pastaj rezulton në mos efikasitetin e kësaj mase të hetimit. Po ashtu, vërehet një mungesë e mekanizmave të inspektimit dhe monitorimit të cilat do të parandalonin keqpërdorimin nga ana e IDS-ve dhe operatorëve të telekomunikacionit. Këto boshllëqe, së bashku me procedurat jo-

² Haxha, 2010

³ Njëra nga rastet është raportuar nga: Spiegel Online, 2008

funkionale të verifikimit të personave të përfshirë në këtë proces, pamundësojnë institucionet e sigurisë që t'i parandalojnë veprat penale në njërin anë dhe të ruajnë e të mbrojnë të drejtën e intimitetit⁴ si e drejtë themelore njerëzore⁵ e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në anën tjetër.

2. PROBLEMET, DUKE FILLUAR NGA DEFINICIONI

Faktori kryesor që çon drejt një hutimi të përgjithshëm sa i përket çështjes së *përgjimit ligjor të telekomunikimeve* në Kosovë është mungesa e një përkufizimi standard në legjislacionin që rregullon këtë çështje. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (KPPP) nuk përcakton se çka nënkuptohet apo kujt i referohet *përgjimi ligjor i telekomunikimeve*, prandaj edhe lë hapësirë që të ngritën supozime mbi këtë çështje. Çka na jep KPPP-ja është ajo se hetimet që bëhen nga shërbimet e telekomunikimit ndahen në: (1) *regjistrimin e thirrjeve telefonike*, (2) *përgjimin e telekomunikimeve*, dhe (3) *përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik*. Përderisa KPPP-ja përcakton se me *regjistrimin e thirrjeve (bisedave) telefonike* nënkuptohet siguri i “të dhënave të bisedave telefonike të bëra nga një numër i caktuar i telefonave,⁶ ajo nuk i përcakton dy masat tjera. Ligjet tjera që merren me rregullimin e këtij aktiviteti japin vetëm referenca të përgjithshme të këtij aktiviteti. Projektligji mbi përgjimin e telekomunikimeve i cili momentalisht është në përpunim e sipër përcakton se çka nënkuptohet me *përgjim* mirëpo në të njëjtën kohë edhe ky projektligj nuk arrin të përcaktoj dhe adresoj diferencat që ekzistojnë ndërmjet masave speciale të hetimit. Megjithatë, vlen të theksohet se ky dokument nuk merret me analizimin e këtij projektligji pasi që ende nuk është aprovuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe ndryshime të theksuara ende mund të priten.

Problemi me mos përcaktimin e qartë të *përgjimit ligjor të telekomunikimeve* në Kosovë është ajo se krijohen vështirësi për Institucionet e Drejtësisë dhe Sigurisë në marrjen e masave të nevojshme për hetimin e krimit dhe mbledhjen e inteligjencës sepse jo të gjitha masat e vëzhgimit dhe hetimit ku përfshihen shërbimet e telekomunikacionit kualifikohen për tu hetuar me përgjim të telekomunikimeve, dhe jo të gjitha këto masa kanë bazë ligjore në legjislacionin e Kosovës. Për shembull, në rastin e kidnapimit të një fëmije 5 vjeçar në marsin e vitit 2011,⁷ për të gjetur pozicionin e kidnapuesve policia ka përdorur *të dhënat mbi lokacionin*⁸ si masë e vëzhgimit të telekomunikimeve. Sipas një ish zyrtari të lartë në njërin nga operatorët e telekomunikacionit në Kosovë⁹ *të dhënat mbi lokacionin* janë marrë nga njëri prej operatorëve të telekomunikacionit. Mirëpo, problemi me këtë qëndron në atë se *të dhënat mbi lokacionin* e përdoruesve të shërbimeve mobile në Kosovë janë fare pak të rregulluara me ligj meqë marrja e këtyre të dhënave në rastin e lartpërmendur nuk kishte bazë ligjore. Mund të ndodh që autoritetet që kanë dhënë urdhrin për marrjen e *të dhënave mbi lokacionin* e kanë interpretuar këtë si *përgjim ligjor i telekomunikacionit*, mirëpo përdorimi i këtyre të dhënave del nga korniza e asaj se çka nënkuptohet me përgjim ligjor të telekomunikimeve. Përderisa përgjimi i

Mungesa e një përcaktimi të përgjimit ligjor të telekomunikimeve në legjislacionin relevant e afekton kualitetin e hetimeve dhe mundësinë për t'i mbrojtur të drejtat e intimitetit.

⁴ Kusht. e Rep. së Kosovës, Neni 36

⁵ Kusht. e Rep. së Kosovës, Neni 53

⁶ UNMIK, KPPP, Neni 256, Paragrafi (10)

⁷ Elezi, 2011.

⁸ Të dhënat mbi lokacionin janë informatat e dhëna nga operatorët e telekomunikacionit të cilat mund të përdoren për identifikimin e vendndodhjes fizike të një individi të caktuar, informacion i cili mund të përdoret edhe për përcjelljen e ndërrimeve të vendndodhjes të individit në fjalë.

⁹ Intervista A, 2011, Prishtinë.

telekomunikimeve i referohet përgjimit të përmbajtjes (komunikimit), direkt apo të regjistruar, të transmetuar ndërmjet dy apo më shumë individëve gjatë përdorimit të shërbimeve të telekomunikacionit (thirrjet telefonike, e-maila, mesazhe, etj),¹⁰ të dhënat mbi lokacionin i referohen të dhënave statike (informacionit si p.sh.: të dhënat mbi lokacionin, të dhënat e trafikut, të dhënat personale).

Të bëhet dallimi mes këtyre masave të hetimit është e një rëndësie të veçantë për shkak të nivelit të ndjeshmërisë që secila nga këto masa mban dhe të konsekuencave që secila nga këto masa mund të ketë në intimitetin e individëve. Për shembull, të merret përmbajtja (komunikimi) duke bërë përgjimin e telekomunikimeve ndërmjet individëve është shumë më e ndjeshme se sa të merren të dhëna statike (informacione) për lokacionin e atyre individëve duke marrë të dhënat mbi lokacionin nga operatorët e telekomunikacionit. Kjo si pasojë ka edhe konsekuenca në kufizimet të cilat i vihen me ligj masave speciale të hetimit. Për shembull, ligji i kufizon më shumë urdhrat e IDS-ve për përgjimin e telekomunikimeve se sa urdhrat e tyre për regjistrimin e thirrjeve telefonike, kjo për shkak të shkallës së ndjeshmërisë që secila nga këto masa ka në intimitetin e individëve.

3. KUFIZIMET QË APLIKOHEN NË PËRGJIMIN LIGJOR TË TELEKOMUNIKIMEVE

Jo të gjitha veprat penale mund hetohen duke përgjuar telekomunikimet. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i parashtron kushtet e ndryshme në bazë të të cilave mund të përdoren masat e ndryshme të vëzhgimit dhe hetimit. Përgjimi i telekomunikimeve mund të urdhërohet vetëm në rast se personi i dyshuar ka kryer “vepër penale të dënueshme me të paktën katër vjet burgim”¹¹ dhe nëse ka kryer një apo më shumë nga 17 vepra tjera penale¹² si përkrahje e terrorizmit dhe krimin të organizuar. Në rast se personi i dyshuar “ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare”, Institucionet relevante të Drejtësisë dhe Sigurisë mund të urdhërojnë masa tjera të vëzhgimit të telekomunikimeve (p.sh mund të kërkojnë regjistrin e thirrjeve telefonike),¹³ por në të cilin rast ata nuk mund të urdhërojnë përgjimin e telekomunikimeve.

Disa limite të aplikuara në përgjimet ligjore të telekomunikimeve sigurojnë mbrojtjen e të drejtës së intimitetit. Sipas një zyrtari të lartë policor¹⁴, kjo ndarje e kushteve është pozitive, jo edhe aq për kualitetin e hetimeve sa për personin e dyshuar. Duke kufizuar praktikën e përgjimit të telekomunikimeve në bazë të kushteve dhe veprave penale të veçanta¹⁵ garantohet mbrojtja e intimitetit si element i rëndësishëm i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (në këtë rast personit të dyshuar). Për më shumë, kjo i ndalon organet e policisë dhe prokurorët, të cilët përndryshe duan të kenë sa më shumë informacione që mundën, që të përzihen në intimitetin e individëve kurdo që ata duan të mbledhin informata.¹⁶ Përderisa këto limite janë të dëshirueshme për shkak të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mos fleksibiliteti i tyre, së paku siç përcaktohet me ligj, mund të ketë efekte anësore në sigurinë kombëtare:

¹⁰ Thorogood, 2007.

¹¹ UNMIK, KPPP, Neni 257, Paragrafi (3); Nënparagrafi 1); (i)

¹² UNMIK, KPPP, Neni 257, Paragrafi (3); Nënparagrafi 1); (ii)

¹³ UNMIK, KPPP, Neni 258, Paragrafi (1); Nënparagrafi 1)

¹⁴ Intervista B, 2011, Prishtinë

¹⁵ UNMIK, KPPP, Neni 257, Paragrafi (3); Nënparagrafi 1); (ii)

¹⁶ Intervista B, 2011, Prishtinë

- **Parashikimi i konsekuencave kriminale të pa dëshiruara:** Kufizimet e aplikuara nuk parashohin veprat penale të cilat, edhe pse nuk kualifikohen për t'u hetuar me përgjime ligjore të telekomunikimeve në fillim, ato mundën prapëseprapë të kenë pasoja të pa dëshiruara në shkatërimin e dëmeve apo krimeve të paparashikuara të cilat përndryshe do të kualifikoheshin për t'u hetuar nëpërmjet përgjimit ligjor të telekomunikimeve. Ka pasur raste kur në të kaluarën këto limite kanë rrezikuar sigurinë kombëtare.¹⁷ Në një rast, disa nga punëtorët e impiantit të 'Ferronikelit' patën kërcënuar menaxhmentin e lartë të kësaj kompanie që në qoftë se nuk paguajnë një shumë të caktuar parash të kërkuar në formë shantazhi, ata do ta shkatërronin sistemin kryesor të lartë-përçuesëve të transmisionit të rrymës. Pasi që prokurori dhe policia e patën kualifikuar këtë aktivitet shantazhi si një 'kërcënim' që nuk është i dënueshëm me më shumë se me 4 vite burgim, gjyqtari i procedurës paraprake nuk e ka aprovuar kërkesën e tyre për përgjim ligjor të telekomunikimeve të të dyshuarve. Sipas një ish-zyrtari të lartë në Policinë e Kosovës,¹⁸ problemi me këtë është se po të lejohej realizimi i kërcënimit sipas planit të tyre, pra shkatërimi i lartë-përçuesve elektrik, atëherë dëmi i cili do të shkaktohej nga një veprim i tillë do të ishte shumë vështirë të riparohet sepse dëmet do ta shkatërronin të gjithë linjën transmetuese të rrymës në atë vend (pra dëmi do të ishte edhe më i madh se ai që planifikohej e parashikohej). Kjo si rezultat ka shtyrë policinë që ta ndryshoj qasjen ndaj këtij krimi duke e kualifikuar atë si të dënueshme me më shumë se 4 vite burgim, në mënyrë që të mund ta marrin aprovimin e kërkesës së tyre për përgjimin e të dyshuarve. Si rezultat i ndryshimit në qasje, dhe me ekzekutimin e përgjimit të telekomunikimeve ndaj të dyshuarve, policia pati arritur që t'i identifikoj personat në mes të nëpunësve të impiantit të përfshirë në këtë vepër shantazhi.
- **Kontrolli gjyqësor:** Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, kur parashtrohet kërkesa për përgjim, njëra nga gjërat që duhet përmendur në kërkesë, mes tjerash, është edhe "deklarat[a] e plotë për faktet që mbështesin kërkesën për të arsyetuar besimin e [parashtruesit të kërkesës]¹⁹ që janë plotësuar kriteret nga neni 257 [i KPPP-së]"²⁰ ashtu që autoriteti relevant gjyqësor (gjyqtari apo gjykata) të mund të vlerësojë nëse përgjimi i telekomunikimeve është masë e nevojshme për hetimin e veprës së caktuar penale. Kjo duket që gjatë procesit të hetimeve siguron një balancë ndërmjet kontrollit gjyqësor (që përkujdeset për mbrojtjen e të drejtave të njeriut) dhe kontrollit ekzekutiv (që përkujdeset për mbledhjen e informacionit dhe fillimit të procedurës penale). Mirëpo vlen të theksohet që përderisa është e nevojshme që kjo balancë të mbahet, gjyqësori jo-efikas në Kosovë mund të mos jetë në gjendje ta vlerësojë nëse një vepër penale mund të konsiderohet apo mund të çoj deri në kërcënimin e sigurisë kombëtare.
- **Efikasiteti:** Jo-fleksibiliteti, apo respektimi në mënyrë strikte, i limiteve që aplikohen ndaj masave speciale të hetimit mund t'i pamundësojnë IDS-të që në disa raste të marrin masa parandaluese. Mund të ketë vepra penale të cilat në fillim nuk kualifikohen për tu hetuar përmes përgjimit të telekomunikimeve por të cilat mund të rriten në vepra më të rënda penale si shkak i mos parandalimit të tyre. Pra, informacionet që do të mund të merreshin nëpërmjet përgjimit të telekomunikimeve në disa raste mund të shërbejnë si informata vitale në parandalimin e rritjes dhe shpërndarjes së krimit.

¹⁷ Marmullaku, 2011, Prishtinë

¹⁸ Marmullaku, 2011, Prishtinë

¹⁹ Informatat në kllapat katrore këtu e më poshtë tregojnë intervenimin e autorit në citatet direkte.

²⁰ UNMIK, KPPP, Neni 258, Paragrafi (3); Nënparagrafi 2)

Në anën tjetër, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencës (AKI) nuk kushtëzon që përgjimi ligjor i telekomunikimeve të kufizohet varësisht nga vepra penale. Kjo për shkak se në bazë të ligjit të lartpërmendur, AKI nuk gëzon fuqi ta arrestoj askënd dhe nuk mund të inicioj procedurë penale kundër askujt;²¹ fushëveprimi i saj kryesisht ka të bëjë me mbledhjen e informacionit dhe inteligjencës lidhur me kërcënimet ndaj “integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale.”²² Pra, me aprovimin nga autoriteti relevant, AKI mund të filloj përgjimin ligjor të telekomunikimeve në përmbushjen e detyrave të saj siç parashihen me ligjin për AKI-në.²³ Analiza që iu është bërë legjislacionit të tanishëm nuk ka çuar deri tek identifikimi dhe përfundimi lidhur me atë se nëse provat e mbledhura nga AKI mund të përdoren në procedurat ligjore kundër ndonjë personi.

4. AUTORITETI I PËRZIER DHE NEVOJA PËR TA PËRCAKTUAR (QARTË) ZOTËRIMIN

Autoriteti se kush mund të urdhëroj përgjimin ligjor të telekomunikimeve në Kosovë është i shpërndarë në disa organe gjyqësore përbrenda strukturave vendore dhe ndërkombëtare. Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, përgjimi ligjor i telekomunikimeve mund të bëhet nga gjykata e procedurës paraprake në bazë të kërkesës nga prokurori publik.²⁴ Gjithashtu, ne raste kur duhet të përgjohet më shumë se një telefon apo pikë komunikuese, urdhri mund të jepet nga kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës kompetente të qarkut.²⁵ Përveç kësaj, ligji për AKI-në i jep gjykatësit të Gjykatës Supreme të drejtën për t’i autorizuar punëtorët e AKI-së që të kryejnë vëzhgimin e telekomunikimeve siç parashihet me ligjin për AKI-në. Gjykata Supreme jep autorizimin “vetëm pas shqyrtimit të kërkesës më shkrim të bërë nën betim dhe të aprovuar nga drejtori i AKI-së apo zëvendës drejtori i AKI-së.”²⁶

Përveç autoriteteve të strukturës vendore të sigurisë, EULEX-i është autoriteti tjetër nën strukturën ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë që duhet të siguroj që veprat penale si, por jo të përkufizuara në krim të organizuar, korrupsion, dhe krime të luftës, të hetohen nga hetues ndërkombëtar.²⁷ Edhe pse kjo lë të nënkuptoj që EULEX-i mund të urdhëroj përgjimin e telekomunikimeve, hulumtimi përgjatë këtij studimi nuk ka çuar deri tek ndonjë referencë të drejtpërdrejt lidhur me këtë çështje.

Shpërndarja e autoritetit i cili mund të urdhëroj këtë masë të hetimit në organe të ndryshme mund të jetë e nevojshme, mirëpo mungesa e bashkëpunimit të duhur dhe mungesa e mekanizmave për shkëmbimin e informatave në mes të autoriteteve të ndryshme mund ta afektoj negativisht kualitetin dhe shpejtësinë e hetimeve. Duket se nuk ekzistojnë rregulla të qarta sa i përket bashkëpunimit ndërmjet IDS-ve përbrenda strukturës vendore të sigurisë (p.sh. përbrenda Policisë së Kosovës apo në mes të Policisë së Kosovës dhe AKI-së), si dhe në mes të IDS-ve vendore dhe atyre ndërkombëtare (p.sh. në mes të AKI-së dhe EULEX-it). Ekzistojnë vetëm disa predispozita në legjislacionin e tanishëm që japin pak ide lidhur me këtë çështje. Sipas nenit 266 të KPPP-së “policia gjyqësore [e cila nuk ekziston], sipas nevojës, mund të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tjera përgjegjëse për zbatimin

²¹ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 3, Paragrafi 3.1

²² Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 2, Paragrafi 2.1

²³ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063

²⁴ UNMIK, KPPP, Neni 258, Paragrafi (2); Nënparagrafi 4) dhe 5)

²⁵ UNMIK, KPPP, Neni 259, Paragrafi (6)

²⁶ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 28, Paragrafi 28.1

²⁷ Prop. Gjithpërfsh. për Zgji. e Stat. të Kosovës, Aneksi IX, Neni 2, Paragrafi 2.3, Nënparagrafi (a)

e ligjit, sigurimin e rendit dhe të një ambienti të sigurt në Kosovë lidhur me zbatimin [e përgjimit ligjor të telekomunikimeve].”²⁸ Për më tepër, sipas Nenit 8, paragrafit 8.3 të ligjit mbi AKI-në “AKI-ja dhe organet e institucionet tjera në Kosovë janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në kryerjen e detyrave të tyre dhe të koordinojnë aktivitetet brenda kompetencave të veta, në harmoni me ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me mbrojtjen e burimeve, metodave dhe informacionit tjetër të klasifikuar.”²⁹ Këto janë predispozitat që më së shumti ofrojnë bazë ligjore sa i përket mekanizmave për bashkëpunimin në mes të IDS-ve, të cilat, siç vërehet, janë mjaft të mjegullta në këtë aspekt.

Megjithatë, këto predispozita nuk ndihmojnë edhe aq në parandalimin e përzierjeve të përgjegjësive dhe detyrave mes aktorëve të sigurisë. Për shembull, një ish zyrtar i lartë i njësisë së hetimeve në Policinë e Kosovës³⁰ shpjegon se si mungesa e bashkëpunimit në mes të njësive të hetimit të rajoneve të ndryshme përbrenda Policisë së Kosovës (p.sh. në mes të Pejës dhe Prishtinës) ka bërë që hetuesit e dy rajoneve ta paraqesin kërkesën për përgjimin e telekomunikimeve të të njëjtit person në të njëjtën kohë dhe për rastin e njëjtë. Po të ishte ndonjë ‘sistem i centralizuar i informimit’ apo një ‘sistem i centralizuar i sinjalizimit’ ku policia do të mund t’i ndajë informatat e nevojshme sa i përket hetimeve dhe të të dyshuarve, këto përzierje të përgjegjësive nuk do të ndodhnin.

Në anën tjetër, sa i përket përgjegjësive dhe aktiviteteve në mes të IDS-ve vendore dhe ndërkombëtare, janë bërë disa përpjekje që të minimizohen përzierjet e mundshme të përgjegjësive dhe aktiviteteve ndërmjet këtyre IDS-ve. Sipas një zyrtari të EULEX-it³¹, ekziston i ashtuquajtur ‘ekipi i përbashkët hetimor’ i cili duhet të koordinoj aktivitetet në mes të Policisë së Kosovës dhe EULEX-it. Mirëpo, përderisa ekipet e përbashkëta hetimore mund të jenë efektive në parandalimin e përzierjeve të mundshme të përgjegjësive, duket se këto ekipe nuk janë aktive në secilin rast. Disa nga hetimet sërish bëhen ndaras dhe në mënyrë të pavarur nga autoritetet vendore (Policisë së Kosovës) dhe atyre ndërkombëtare (EULEX-it), e ku qasja e tillë në disa raste është dëshmuar të jetë jo-efektive. Për shembull, në rastet kur hetimet janë bërë në mënyrë të pavarur nga autoritetet vendore dhe ndërkombëtare, ka bërë që njësitë e hetimeve të këtyre autoriteteve të ndërhyjnë në përpjekjet e secilit nga ta për ta hetuar rastin e njëjtë. Kjo ka bërë që në realitet personi i dyshuar të arrestohet nga njëri autoritet përderisa njësia e hetuesisë së autoritetit tjetër ende ka qenë në proces të përgjimit të telekomunikimeve të të njëjtit person në përpjekjet e tyre për të mbledhur më shumë informacion.³²

Mungesa e një zotërimi të qartë mbi përgjimin ligjor të telekomunikimeve në Kosovë e afekton drejtpërsëdrejti kualitetin e hetimeve.

Njëra nga arsytet pse ndodhë që këto autoritete të punojnë në mënyrë të pavarur dhe pa një bashkëpunim të përhershëm ndërmjet tyre është fakti se institucionet vendore dhe ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Sigurisë kanë nënshkruar marrëveshje ndaras dhe në mënyrë të pavarur me operatorët e telekomunikacionit.³³ Një aranzhim i tillë jep hapësirë që ankesat t’i drejtohen aktorëve të ndryshme të sigurisë veç e veç. Një rast që ilustron një gjendje të tillë është rasti i ankesave në drejtim të EULEX-it për faktin që ata përgjojnë pa ndonjë koordinim më autoritetet vendore të sigurisë. P.sh.

²⁸ UNMIK, KPPP, Neni 266

²⁹ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-nw, Nr. 03/L-063, Neni 8, Paragrafi 8.3

³⁰ Marmullaku, 2011, Prishtinë

³¹ Intervista D, 2011, Prishtinë

³² Marmullaku, 2011, Prishtinë.

³³ Haxhiu dhe Kostanica, Klan Kosova, 2010 (Në këtë kohë, Ipko ishte ende në proces të negocimit të marrëveshjes ndaras me IDS-të vendore dhe ndërkombëtare).

përpjekja e Ministrit të Brendshëm, Bajram Rexhepi, për të marr nën kontroll dy pikat kufitare në pjesën veriore të Kosovës, tash së voni, është kritikuar nga komisioni relevant parlamentar për atë se Ministri e kishte urdhëruar aksionin vetëm dy orë para se ky aksion të ndodhte. Ministri kishte thënë se ka qenë i detyruar ta bënë një gjë të tillë pasi që ishte i sigurt se autoritetet ndërkombëtare vazhdimisht i përgjonin bisedat e tij me Kryeministrin, dhe kishte frikë që nëse autoritetet ndërkombëtare do ta kuptonin planin për operacionin policor, atëherë ai do të pengohej nga autoritetet ndërkombëtare. Ai së pari fajin për përgjimin e telekomunikimeve të tij e pati drejtuar tek Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe pastaj tek EULEX-i, duke thënë se këto autoritete ndërkombëtare ia përgjonin telekomunikimet tani e sa kohë.³⁴ Përderisa rregullat e bashkëpunimit në mes të aktorëve vendor dhe ndërkombëtar të sigurisë ende nuk janë të qarta, EULEX-i ka deklaruar që ata i ndjekin procedurat e njëjta të përshkuara në KPPP dhe procedurat të cilat ndjekën nga vet aktorët vendor.³⁵ Kur është pyetur për këtë rast, Kryeprokurori i Republikës së Kosovës ka thënë se “nëse ministri bënë një kallëzim penal, Prokuroria do të veprojë në përputhje me ligjin, megjithëse ka sqaruar se ndërkombëtarët gëzojnë imunitet [mbi këto çështje].”³⁶

Pra, siç shihet në përgjithësi, mjedisi i sigurisë në Kosovë i cili karakterizohet me prezencën e shumë aktorëve të sigurisë me mandate të përziera dhe të pa përkufizuara mirë si dhe mekanizmat e dobëta të bashkëpunimit sa i përket përgjimit të telekomunikimeve dukshëm e vështirëson hetimin kualitativ dhe mbrojtjen e të drejtave të intimitetit.

5. PROCEDURAT

5.1. Procesi

Sa i përket procedurës që duhet ndjekur për realizimin e përgjimit të telekomunikimeve, duket se kjo përgjithësisht varet nga legjislacioni përkatës që e rregullon atë. Nuk ka ndonjë procedurë standarde që ndjeket kur bëhet përgjimi i telekomunikimeve. Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, pasi që bëhet aplikimi (parashtrohet kërkesa) tek autoritetet relevante për këtë, prokurori publik apo Zyrtarë të Autorizuar të Policisë Gjyqësore (ZAPGj) marrin urdhrin për përgjim me informatat relevante të cilat përfshinë³⁷:

1. Emrin dhe adresën e personit ose të personave që i nënshtrohen urdhrin;
2. Llojin e masës;
3. Arsyet e urdhrin;
4. Periudhën brenda së cilës urdhri do të ketë efekt e që nuk mund të kalojë gjashtëdhjetë ditë nga dita e marrjes së urdhrin; dhe
5. Agjencinë e policisë gjyqësore të autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.

Pastaj, ky urdhër duhet të përmbajë një aneks (shtojcë) që përmban në formë të shkruar udhëzimet e adresuara tek personi ndihma e të cilit është e nevojshme për zbatimin e urdhrin, në këtë rast “drejtorit

³⁴ Kajtazi, 2011.

³⁵ Intervista D, 2011, Prishtinë. Shiko po ashtu: Kajtazi, 2011.

³⁶ Kabashi 2011.

³⁷ UNMIK, KPPP, Neni 259, Paragrafi (1)

ose personit përgjegjës të sistemit të telekomunikimeve, rrjetit kompjuterik, [...] dhe duhet të përfshijë vetëm informacionin që kërkohet për ndihmë për zbatimin e urdhrit”³⁸

Është vështirë të gjykohet roli i personelit ndihmës në operatorin e telekomunikacionit në këtë punë, mirëpo sipas një ish zyrtari të lartë³⁹ në Ipko Telecommunications, personi i përfshire në këtë aktivitet nga ana e operatorit e ka një zyrë të veçantë në ndërtesën e operatorit ku identiteti i tyre dhe përshkrimi i punës së tyre nuk ndahet me nëpunësit tjerë të operatorëve të telekomunikacionit. E njëjta duket të jetë edhe në rastin e operatorit tjetër (PTK-së), kryeshefi i së cilit, Shyqyri Haxha, ka thënë se “asnjë punëtor apo menaxher i PTK-së, asnjëherë nuk ka pasur qasje, aty punojnë një ekip i punonjësve që janë shumë konfidencial dhe se puna aty kryhet me profesionalizëm pa pjesëmarrje të stafit menaxherial të PTK-së.”⁴⁰ Sido që të jetë, shumë pak dihet nëse personi ndihmës tek operatorët e telekomunikacionit të përfshirë në ofrimin e ndihmës siç përshkruhet në KPPP, kalon nëpër procedurat e verifikimit të besueshmërisë dhe personalitetit të tyre.

5.2. Rastet e ngutshme

Urdhri për përgjimin e telekomunikimeve në raste të ngutshme varet nga ligji. Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale “në rastet e ngutshme, kur pritja e urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake [...] do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre, prokurori publik mund të jep urdhër të përkohshëm për njërën nga masat e parapara në paragrafin 2 të [Neni 258]. Urdhri i tillë i përkohshëm e humb fuqinë nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda njëzet e katër orëve [24] nga lëshimi.”⁴¹ Mirëpo, sipas ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencës në situata të ngutshme “kur koha nuk lejon përgatitjen e një kërkesë me shkrim nga ana e drejtorit të AKI-së apo zëvendës drejtorit të AKI-së apo dhënien e një urdhri me shkrim nga ana e një gjyqtari të Gjykatës Supreme, kërkesa mund të bëhet dhe urdhri për përgjim të fshehtë mund të jepet gojarisht, për t'u konfirmuar më shkrim brenda dyzetetë (48) orësh.”⁴² Edhe pse ka një ndeshje ndërmjet KPPP-së dhe ligjit për AKI-në sa i përket rregullimit të periudhës së urdhrit të përkohshëm, shqetësimi më i madh qëndron në monitorimin e rasteve të ngutshme, e sidomos në bindjen që urdhrat e përkohshme përfundojnë se funksionuari siç parashihet me ligj.

5.3. Mekanizmat mbrojtës

KPPP-ja i shtjellon disa mekanizma për mbrojtjen e informacionit dhe intimitetin e individëve. Një dispozitë e tillë jepet me atë se përgjimi i telekomunikimeve lejohet vetëm atëherë kur “informacioni i

Ekzistojnë disa mekanizma mbrojtës që parashihen me legjislacionin e të cilat mbrojnë informacionin dhe intimitetin e individëve.

cili mund të merrej nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.”⁴³ Një mekanizëm tjetër mbrojtës është predispozita që jepet në KPPP ku thuhet që “prova e marrë nëpërmjet

[përgjimit të telekomunikimeve] është e papranueshme nëse urdhri për masën dhe zbatimin e saj është i paligjshëm.”⁴⁴ Po ashtu “periudh[a] brenda së cilës urdhri do të ketë efekt [...] nuk mund të kalojë

³⁸ UNMIK, PCPC, Neni 259, Paragrafi (8)

³⁹ Intervista A, 2011, Prishtinë.

⁴⁰ Haxha, 2010.

⁴¹ UNMIK, KPPP, Neni 258, Paragrafi (4)

⁴² Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 29

⁴³ UNMIK, KPPP, Neni 257, Paragrafi (1) dhe (3), nënparagrafi 2)

⁴⁴ UNMIK, KPPP, Neni 264, Paragrafi (1)

gjashtëdhjetë ditë nga dita e marrjes së urdhrimit”⁴⁵ është një predispozitë tjetër e dhënë në KPPP që shërben si mekanizëm mbrojtës. Në qoftë se predispozitat e lartpërmendura shkelen, apo në qoftë se një subjekt është përgjuar në mënyrë joligjore, ‘paneli për vëzhgim dhe rishqyrtim të hetimeve’ duhet ta kompensoj subjektin, t’i ndërpres urdhrat, dhe të urdhëroj shkatërrimin e materialit.⁴⁶

Limitet të cilat parashihen me ligjin për AKI-në për nëpunësit e AKI-së, po ashtu shërbejnë si mekanizma mbrojtës. AKI nuk gëzon të drejta për të kryer funksione ekzekutive dhe nuk ka: “(1) të drejtë të përdorë forcë direkte apo indirekte; (2) çfarëdo autoriteti për arrest; (3) mundësinë të iniciojë procedura penale; dhe (4) autorizimin të detyrojë persona apo kompani të bashkëpunojnë për aktivitetet e saj, ndonëse persona apo kompani mund të bashkëpunojnë me AKI-në mbi baza vullnetare.”⁴⁷

5.4. Mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit

Kosova ka themeluar komisione relevante parlamentare për mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë ashtu që të garantohet kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë, siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁴⁸ Ekzistojnë dy komisione parlamentare që mbikëqyrin sektorin e sigurisë në Kosovë: Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë të Kosovës për Inteligjencë. Nuk duket që këto komisione të kenë ndonjë obligim të rreptë për kontrollimin dhe monitorimin e përgjimit të telekomunikimeve. Megjithatë, Ligji për Hetim Parlamentar jep një bazë ligjore për ta krijuar një Komision Hetues për të “hetuar probleme e çështje ku janë drejt për së drejti të përfshira përgjegjësitë qeveritare apo shtetërore.”⁴⁹ Ky komision po ashtu mund “të i thërras bartësit e funksioneve publike të dëgjohen para Komisionit”⁵⁰ përbrenda mandatit të tij. Mirëpo, përderisa ky ligj i jep mandat këtij Komisioni për të hetuar raste të ndryshme, e cila mund të përfshijë rastet që kanë të bëjnë me përgjimin e telekomunikimeve, ky ligj nuk i jep Komisionit një mandat direkt për kontrollimin dhe monitorimin e aktiviteteve të tilla hetuesie.

Përderisa KPPP-ja nuk jep asnjë detaj sa i përket mekanizmave demokratik apo çfarë do tjetër mbikëqyrës dhe monitorues, ligji për AKI-në jep disa predispozita lidhur me këtë. Aktivitetet e AKI-së mbikëqyren nga Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, i cili mes tjerash është përgjegjës që të “mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së AKI-së; shqyrtojë raportet e drejtorit të AKI-së në lidhje me operacionet dhe shpenzimet e AKI-së; shqyrtojë raportet e inspektorit të përgjithshëm; kryejë hetime në lidhje me punën e AKI-së”.⁵¹

Sa i përket organeve të pavarura, edhe pse ankesat lidhur me institucionet vendore të sigurisë mund të adresohen tek Ombudspersoni, siç parashihet në ligjin për AKI-në,⁵² Ombudspersoni, si një institucion i pavarur, nuk ka mandat për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e masave hetimore, apo të përgjimit ligjor më konkretisht, që ndërmerren nga Policia e Kosovës, AKI, dhe EULEX-i. Përderisa Ombudspersoni ka mandat që të merret me institucione vendore, Bashkimi Evropian, për shembull, ka

⁴⁵ UNMIK, KPPP, Neni 259, Paragrafi (1), nënparagrafi 4)

⁴⁶ UNMIK, KPPP, Neni 265

⁴⁷ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 3, Paragrafi 3.1

⁴⁸ Kusht. e Rep. së Kosovës, Neni 125

⁴⁹ Rep. e Kosovës, Ligji për Hetim Parlamentar, Nr. 03/L-176, Neni 2, Paragrafi 2

⁵⁰ Rep. e Kosovës, Ligji për Hetim Parlamentar, Nr. 03/L-176, Neni 13, Paragrafi 1.1

⁵¹ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 36. Shih po ashtu Nenet 37 dhe 38 në ligjin e njëjtë

⁵² Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 39, Paragrafi 39.2

themeluar një organ të pavarur monitorues, Panelin për Vëzhgim dhe Rishqyrtim të të Drejtave të Njeriut, në mënyrë që të mbikëqyrë përgjegjësinë e përgjithshme të EULEX-it. Ky organ mbikëqyrë njësinë e brendshme të hetimeve në EULEX dhe Skemën e Sigurisë së Detyrimeve të Palës së Tretë në mënyrë që të rishqyrtohen ankesat e dhëna ndaj ndonjë shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it.⁵³

Po ashtu nuk ka ndonjë indikacion mbi ekzistencën e ndonjë mekanizmi formal të mbikëqyrjes dhe inspektimit të brendshëm të Institucioneve të Drejtësisë dhe Sigurisë kur ato ekzekutojnë urdhrat për përgjimin ligjor të telekomunikimeve. KPPP i obligon Zyrtarët e Autorizuar të Policisë Gjyqësore që të “shëno[jnë] kohën dhe datën e fillimit dhe të përfundimit të secilit veprim të ndërmarrë për zbatimin e urdhrat. [Po ashtu shton se] në procesverbal shënohen emrat e zyrtarëve të autorizuar të policisë gjyqësore të cilët kanë ndërmarrë cilindo veprim dhe funksion.”⁵⁴ Mirëpo duket se nuk ka mekanizma të cilat rregullohen me ligj apo që zbatohen në praktikë ku gjyqësori (gjyqtari apo gjykata) marrin përgjegjësi për mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të urdhrave apo edhe ndonjë mekanizëm inspektues të brendshëm përbrenda IDS-ve i cili do t'i mbikëqyrte aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në gjithë procesin e përgjimit të telekomunikimeve si në anën e IDS-ve ashtu edhe në anën e operatorëve të telekomunikacionit.

Ombudspersoni, si një institucion i pavarur, nuk e gëzon mandatin të mbikëqyrë dhe kontrollojë përgjimin ligjor të telekomunikimeve që ndërmirren nga Policia e Kosovës, AKI, dhe EULEX-i

6. ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTAT E NJERIUT

Përgjimi ligjor mendohet që është një masë që nuk zgjon shume besim nga publiku në përgjithësi, sepse ata besojnë që kjo masë hetuesie ia shkel njëri nga të drejtat më themelore të njeriut, atë të intimitetit. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale përpiqet që me disa nga predispozitat e tij ku përshkruhet fushëveprimi, procedura, dhe të drejtat e palëve të ndryshme të përfshira në përgjimit të telekomunikimeve, të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Për shembull, ekzistojnë dy elemente kyçe që një i dyshuar i gëzon sa i përket përgjimeve, e të cilat jepen nga KPPP-ja:

1. Të drejtën të qaset në materialet e mbledhura që rrjedhin nga urdhri për hetimin e subjektit në fjalë;⁵⁵ dhe
2. Të drejtën për tu informuar nga prokurori publik (kur nuk ka dyshime të bazuara) për urdhrin e hetimit ndaj tij ose saj.⁵⁶

Megjithatë, prapë mbesin disa mangësi sa i përket mbrojtjes së drejtave të njeriut. Për shembull, duke theksuar se “zbatimi i urdhrat kryhet në atë mënyrë që të minimizojë përgjimin e komunikimeve të cilat në të kundërtën nuk i nënshtrohen përgjimit.”⁵⁷ KPPP-ja u jep IDS-ve fleksibilitetin për t'i përgjuar individët që në fakt nuk janë të dyshuar. Kjo ndodh sepse në vend se të ndalohet përgjimi i komunikimeve që nuk duhet të përgjohen, KPPP-ja i detyron IDS-të vetëm ta minimizojnë një praktikë të tillë.

⁵³ Paneli Mbikëqyrës i të Drejtave të Njeriut, 2011.

⁵⁴ UNMIK, KPPP, Neni 260, Paragrafu (4)

⁵⁵ UNMIK, KPPP, Neni 263, Paragrafi (1), Nënparagrafi 1)

⁵⁶ UNMIK, KPPP, Neni 263, Paragrafi (1), Nënparagrafi 2)

⁵⁷ UNMIK, KPPP, Neni 260, Paragrafi (2)

Përveç kësaj, ekziston edhe një potencial i shkeljes të së drejtës së intimitetit kur IDS-të dërgojnë urdhrin (aneksin) tek operatorët e telekomunikacionit. Edhe pse aneksi i cili u jepet operatorëve të telekomunikacionit për të ekzekutuar urdhrin nuk përmban informatat lidhur me identitetin e personit nën hetimin në fjalë, rregullorja e re e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART) lidhur me regjistrimin e numrave të telefonit mobil⁵⁸ e bënë urdhrin (aneksin) më të ndjeshëm ndaj shkeljeve të drejtave të intimitetit. Kjo rregullore e re i obligon të gjithë personat fizik dhe juridik që t'i regjistrojnë emrat dhe detajet tjera personale, duke përfshirë edhe adresën, me SIM kartelën (numrin e telefonit) e tyre. Me fjale tjera, nuk do të duhej të ketë SIM kartelë në treg e cila nuk ka pronar të caktuar të regjistruar. Në këtë aspekt, kur Institucionet e Drejtësisë dhe Sigurisë e dorëzojnë aneksin tek operatorët e telekomunikacionit, paraqet një rrezik të drejtpërdrejt në shkeljen e të drejtës së intimitetit për shkak së duke e marrë parasysh që në aneks ceket numri i telefonit i të dyshuarit si informatë bazike që mundëson që urdhri të ekzekutohet me sukses, atëherë vetëm fakti që ai numër tanimë (për shkak të rregullores së re) është i lidhur edhe me emrin e personit, paraqet rrezik që emri dhe detajet tjera të të dyshuarit të mund të zbulohen nga numri i tij i telefonit. Pra, predispozitat e KPPP-së që kanë të bëjnë me maskimin e identitetit të të dyshuarit kur e japin aneksin, në këtë rast janë të pavlefshme.

Një problem tjetër sa i përket intimitetit të individëve mbetet me faktin që përgjimet e ndërmarra nga autoritetet ndërkombëtare duhet të përkthehen. Sipas një punëtori në prokurori⁵⁹, gjatë periudhës së administrimit të UNMIK-ut në Kosovë, ishin përkthyesit vendor ata të cilët u përfshinë në përkthimin e skripteve (materialit të përgjuar) në gjuhë të ndryshme, shqip, serbisht, dhe gjuhë tjera. Ka shumë pak informata që mund të na tregojnë nëse këta përkthyes kanë kaluar ndonjë procedurë verifikimi personal apo besueshmërisë së tyre, megjithatë, kjo praktikë ngre shqetësime sa i përket aftësisë së IDS-ve që të mbrojnë intimitetin jo vetëm të të dyshuarve, por edhe të personave që kanë komunikuar me të dyshuarit. Edhe pse UNMIK-u kishte aplikuar disa mekanizma mbrojtës, për rastin në fjalë, ku përkthyesve iu kishin dhënë materialet e ndara në disa pjesë dhe të përziera ashtu që përkthyesit të mos e kuptojnë të gjithë ngjarjen që është marrë nëpërmjet përgjimit, prapëseprapë mund të konsiderohet që përkthyesit përfshihen në informata mjaft të ndjeshme. Njësoj sikurse UNMIK-u, edhe EULEX-i i cili përgjon telekomunikime në ditët e sotit, duhet të përfshijë përkthyes vendor për të përkthyer materialet e përgjuara. Në këtë aspekt, edhe pse ligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë është aprovuar, Departamenti për Verifikimin e Besueshmërisë, i cili do të duhej të krijohej nga AKI, siç ceket në ligjin relevant⁶⁰ ende nuk është funksionalizuar.⁶¹ Kjo pra e bënë të pamundur që aktorët ndërkombëtar të sigurisë, në këtë rast EULEX-i, t'i përdorin procedurat e verifikimit të besueshmërisë së individëve të përfshirë në përkthimin e materialit të përgjuar.

Një problem tjetër sa i përket intimitetit të individëve mbetet me faktin që përgjimet e ndërmarra nga autoritetet ndërkombëtare duhet të përkthehen. Sipas një punëtori në prokurori⁵⁹, gjatë periudhës së administrimit të UNMIK-ut në Kosovë, ishin përkthyesit vendor ata të cilët u përfshinë në përkthimin e skripteve (materialit të përgjuar) në gjuhë të ndryshme, shqip, serbisht, dhe gjuhë tjera. Ka shumë pak informata që mund të na tregojnë nëse këta përkthyes kanë kaluar ndonjë procedurë verifikimi personal apo besueshmërisë së tyre, megjithatë, kjo praktikë ngre shqetësime sa i përket aftësisë së IDS-ve që të mbrojnë intimitetin jo vetëm të të dyshuarve, por edhe të personave që kanë komunikuar me të dyshuarit. Edhe pse UNMIK-u kishte aplikuar disa mekanizma mbrojtës, për rastin në fjalë, ku përkthyesve iu kishin dhënë materialet e ndara në disa pjesë dhe të përziera ashtu që përkthyesit të mos e kuptojnë të gjithë ngjarjen që është marrë nëpërmjet përgjimit, prapëseprapë mund të konsiderohet që përkthyesit përfshihen në informata mjaft të ndjeshme. Njësoj sikurse UNMIK-u, edhe EULEX-i i cili përgjon telekomunikime në ditët e sotit, duhet të përfshijë përkthyes vendor për të përkthyer materialet e përgjuara. Në këtë aspekt, edhe pse ligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë është aprovuar, Departamenti për Verifikimin e Besueshmërisë, i cili do të duhej të krijohej nga AKI, siç ceket në ligjin relevant⁶⁰ ende nuk është funksionalizuar.⁶¹ Kjo pra e bënë të pamundur që aktorët ndërkombëtar të sigurisë, në këtë rast EULEX-i, t'i përdorin procedurat e verifikimit të besueshmërisë së individëve të përfshirë në përkthimin e materialit të përgjuar.

Përderisa KPPP-ja nuk jep asgjë të qartë lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ligji për AKI-në jep disa predispozita në këtë drejtim. Ky ligj thekson se "AKI-ja respekton parimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, dhe

⁵⁸ Rep. e Kosovës, Rregullorja e ART-së, Nr. 3. Shih po ashtu: Vendimin e ART-së, Nr. Prot. 015/B/11

⁵⁹ Intervista C, 2011, Prishtinë.

⁶⁰ Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-178, Neni 24, Paragrafi 2

⁶¹ QKSS, et. al., Raporti i Progresit Made in Kosova, 2011.

parimet tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarisht dhe kryen aktivitetet e veta në pajtueshmëri me to,”⁶² e të cilat nuk jepen në KPPP.

7. OPERATORËT E TELEKOMUNIKACIONIT

Avancimet e vazhdueshme në industrinë e telekomunikacionit po ua mundësojnë qytetarëve në Kosovë që të përdorin një sërë shërbimesh të telekomunikacionit. Ka një rritje të dukshme në numrin e përdoruesve të telefonisë mobile, internetit, dhe shërbimeve tjera të telekomunikacionit. Sipas Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionet, në Kosovë ka 48 operatorë të telekomunikacionit të cilët kanë së paku nga një licencë shërbimi të telekomunikacionit të lëshuar nga ART-ja,⁶³ të cilat shërbime edhe mund të jenë objekt i përgjimit. Mes këtyre operatorëve, momentalisht janë tre operatorë të telefonisë fikse, dy operatorë të telefonisë mobile, dhe dy Operator të Rrjetit Mobil Virtual (ORrMV). Shumica e licencave tjera janë për ofrues të shërbimeve të internetit (OSHI) dhe ofrueseve të shërbimeve me vlerë të shtuar (ShVSh).⁶⁴ Këto avancime, si në përdorimin e shërbimit ashtu edhe në rritjen e tyre, medoemos i ngrisin edhe mënyrat se si IDS-të duhet të përgjojnë telekomunikimet.

Operatorët e telekomunikacionit luajnë një rol kyç në mbrojtjen dhe garantimin e intimitetit individual sepse këta operatorë i ofrojnë si burimet njerëzore ashtu edhe ato teknike për një mbarëvajtje të suksesshme të procesit të përgjimit ligjor si dhe shërbejnë si depo e të dhënave personale të klientëve që në të shumtën e rasteve janë shumë të ndjeshme. Mirëpo, kur e shikojmë legjislativën e tanishëm në përgjithësi shihet se vetëm pak thuhet lidhur me standardizimin dhe menaxhimin e bashkëveprimit midis IDS-ve dhe operatorëve të telekomunikacionit.

Operatorët e telekomunikacionit jo gjithmonë u janë përgjigjur urdhërave të institucioneve të sigurisë.

Së pari, urdhrat e lëshuara nga IDS-të nuk janë trajtuar në mënyrë konsistente, që do të thotë se operatorët e telekomunikacionit jo gjithmonë u janë përgjigjur urdhrat të cilat janë lëshuar nga IDS-të. Për shembull, ka qenë dikur deri në vitin 2010 kur IDS-të kanë mundur të ekzekutojnë përgjim ligjor vetëm për konsumatorët e operatorit të Vala-s⁶⁵; dhe vetëm pas këtij viti ka filluar përgjimi i konsumatorëve të operatorit Ipko.⁶⁶ Kjo ka shtyrë disa konsumatorë të Vala-s që ta ndërrojnë operatorin për shkak të frikës nga ekspozimi në përgjime të konsumatorëve të këtij operatori. Në këto rrethana, disa e patën interpretuar si mungesë e vullnetit të Ipko-së për të lejuar IDS-të që t’i përgjojnë konsumatorët e tyre si një strehë e sigurt fshehjeje për të dyshuarit potencial. Kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e lëshuara nga kryeshefi i PTK-së i cili pati deklaruar: “kemi shumë raste kur konsumatorët janë trembur nga përgjimet dhe kanë ikur nga ne, pikërisht për këtë arsye operatori tjetër ka përfituar.”⁶⁷ Ndërsa, një zyrtar kompetente në Ipko ka deklaruar që ata kanë vepruar strikt siç parasheh Kodi i Procedurës Penale.⁶⁸

⁶² Rep. e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 2, Paragrafi 2.5

⁶³ Rep. e Kosovës, ART, 2011.

⁶⁴ Rep. e Kosovës, ART, 2011.

⁶⁵ Vala është operatori mobil ndër menaxhim të PTK-së

⁶⁶ Kosova Sot, 2010.

⁶⁷ Haxha, 2010.

⁶⁸ Kostanica, Klan Kosova, 2010

Së dyti, kapacitetet dhe mundësitë e operatorëve të telekomunikacionit për të ekzekutuar urdhrat e Institucioneve të Drejtësisë dhe Sigurisë janë të ndryshme. Në ekzekutimin e njërit prej urdhrat të tyre me PTK-në, për shembull, IDS-ve u është lejuar qasja në të gjithë bazën e të dhënave të konsumatorëve (mundësi që IDS-të të përgjojnë edhe numra tjerë), meqë rast është bërë ekspozimi i shumë informatave të panevojshme drejt IDS-ve, gjë e cila ka mundësuar potencialin për ndonjë keqpërdorim. Është vështirë të vërtetohet nëse rasti i PTK-së është i vërtet, mirëpo bazuar në ish zyrtarin e lartë në Policinë e Kosovës⁶⁹ ka ekzistuar mundësia që me PTK-në të ketë qasje në tërë bazën e të dhënave të konsumatorëve të tyre. Kjo sipas disa ekspertëve të telekomunikacionit bëhet për shkak të mungesës së kapacitetit teknik i cili do duhej ta kufizonte qasjen vetëm në numrin e caktuar. Megjithatë, duket se në këtë drejtim ka ndryshime nga ana e PTK-së dhe ka indikacione që praktika të tilla më nuk ka. Në anën tjetër, Ipko duket të ketë qenë më vigjilent në ofrimin e teknologjisë së duhur për të ofruar kufizimet e nevojshme ashtu që të drejtat e intimitetit të personave jashtë hetimit mos të cenohen. Kjo, sipas përfaqësueses kompetente të Ipko-së është mundësuar për shkak të specifikave teknike që ata i kanë zbatuar.⁷⁰

Infrastruktura e disa operatorëve të telekomunikacionit ka treguar se nuk përshatet me kërkesat legislative për mbrojtjen e të dhënave të konsumatorit dhe të drejtën e intimitetit.

Më shqetësuese është mungesa e mekanizmave të inspektimit të operatorëve të telekomunikacionit. Mekanizmat mbrojtës dhe ata pak mekanizma monitorues dhe kontrollues që ekzistojnë në anën e IDS-ve mungojnë tërësisht tek ana e operatorëve të telekomunikacionit. Po ashtu duket se nuk bëhet asnjë inspektim i këtyre operatorëve dhe nëpunësve relevant të tyre që janë të përfshirë në zbatimin e urdhrat për përgjim (së paku pjesën apo obligimin që ata e kanë), për t'u siguruar që të dhënat e konsumatorëve nuk keqpërdoren. Ka shembuj nga e kaluara ku sistemi është keqpërdorur në anën e operatorit. Disa nëpunës të Vala-s deklarojnë që sot askush në PTK nuk bën përgjime në mënyrë të paligjshme, mirëpo ata e pohojnë faktin që ka pasur raste më herët kur në të kaluarën menaxhmenti i mëhershëm ka bërë përgjime të pa-autorizuara.⁷¹

8. NJË TREGIM PËR AKTORËT NËN HIJE

Prezenca e një numri të madh aktorësh që mund të përfshihen në përgjimin ligjor të telekomunikimeve si nga Institucionet vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Sigurisë si dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet tyre nuk është shqetësimi i vetëm. Deri më tani në Kosovë ka pasur prezencë të konsiderueshme të aktorëve të ndryshëm të informimit dhe inteligjencës. Sipas një raporti,⁷² Shërbimi Informativ i Kosovës dhe Instituti për hulumtime Strategjike të Opinioneve Publikë kanë funksionuar së paku për një kohë në periudhën e pas luftës, mirëpo shumë pak dihet nëse ata kishin ose vazhdojnë të kenë kapacitetet për përgjim të telekomunikimeve. Në këtë kontekst, shuarja e tyre⁷³ tani së voni lë pak hapësirë për shqetësime lidhur me ekzistencën e tyre, e shumë më shumë hapësirë për shqetësime lidhur me përdorimin dhe ndodhjen e kapaciteteve të tyre.

Ekziston edhe një anë (aktive) që vazhdon të qëndroj nën hije e që ka të bëjë me infrastrukturën e tanishme të telekomunikimeve në Kosovë. Kosova vazhdon ta përdorë kodin shtetëror telefonik të

⁶⁹ Marmullaku, 2011, Prishtinë.

⁷⁰ Kostanica, Klan Kosova, 2010

⁷¹ Ekonomisti, 2011.

⁷² Peci dhe Dugolli, 2006.

⁷³ Ekonomia, p.d.

Serbisë (+381) për shërbimet e saj të telefonisë fikse, e cila jep hapësirë për shumë shqetësime sa i përket sigurisë kombëtare. Të gjitha thirrjet që vijnë në Kosovë nga jashtë kalojnë kah centralja në Beograd të cilat pastaj ridrejtohen në Prishtinë. Sipas një eksperti në këtë fushë dhe ish punëtor në njërin nga operatorët e telekomunikacionit, autoritetet Serbe mundën, sipas dëshirës së tyre, të monitorojnë, të regjistrojnë, dhe të përgjojnë thirrjet ndërkombëtare që vijnë në Kosovë nga jashtë.⁷⁴ Përveç kësaj, sipas një zyrtari të lartë në Policinë e Kosovës, i cili dukej të merrej vesh në anën teknike të kësaj fushe ka pohuar se mundësia që Serbia të mund të përgjoj këto thirrje ekziston.

A besojnë institucionet qeveritarë në Kosovë që ndërlidhja e tanishme ndërkombëtare e telefonisë fikse nuk keqpërdoret nga Serbia?

“Teknikisht mund të behët ajo, dhe nuk është shumë vështirë, ne nuk do të mund ta dimë kurrë, mirëpo mundësia që një gjë e tillë të bëhet nga ana e Serbisë ekziston.”⁷⁵ Pra duket se kjo mbetet të jetë më shumë çështje e vullnetit të Serbisë se sa çështje e mundësisë teknike për ta bërë një gjë të tillë. Nëse kjo mbetet nën vullnetin dhe mëshirën e Serbisë,

atëherë gjendja ekzistuese (status quo) mbetet të jetë çështje e besimit e autoriteteve në Kosovë; pra a mendojnë institucionet qeveritarë në Kosovë që infrastruktura e tanishme e linjës fikse nuk keqpërdoret nga Serbia? Nëse konsiderohet fakti që në Kosovë ka më shumë se 80,000 përdorues të telefonisë fikse⁷⁶ si dhe fakti që shumica e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare e përdorin linjën fikse për të pranuar thirrje nga jashtë, lë shumë hapësirë për shqetësime lidhur me sigurinë në Kosovë. Pak dihet për vëllimin e përdorimit të telefonisë fikse nga zyrtarë të lartë në Kosovë, pa marr parasysh në shtëpi apo në zyrë, mirëpo kjo çështje meriton një hulumtim dhe studim të thukët.

Përveç shqetësimeve për sigurinë që jep ndërlidhja e tanishme ndërkombëtare e linjës së fiksit, prezenca e gjerë e infrastrukturës mobile të Serbisë në Kosovë mund të konsiderohet si kërcënim për sigurinë kombëtare dhe atë të publikut, në disa nivele. Shumica e enklavave Serbe në Kosovë janë të mbuluara me infrastrukturën e një operatorit mobil nga Serbia, e cila mundëson që një numër i konsiderueshëm i njerëzve të përdorin shërbime të telefonisë mobile në mënyrë ilegale. Kjo bënë që edhe Institucionet vendore edhe ato ndërkombëtarë të Drejtësisë dhe Sigurisë të kenë të pa mundur që të përgjojnë telekomunikimet e rreth 120,000 njerëzve në Kosovë që përdorin këto shërbime ilegale.⁷⁷ Po ashtu, prezenca e infrastrukturës ilegale serbe në Kosovë mund të jep strehim të sigurt jo vetëm për popullatën serbe por edhe për atë pjesë të popullsisë që kalojnë apo jetojnë aty pranë ku ka mbulesë me infrastrukturë ilegale. Prandaj, përgjimi i telekomunikimeve, si një mase speciale dhe efektive e hetimit, mund të mos përdoret për hetimin e një numri të konsiderueshëm të popullsisë në disa pjesë në territorin e Kosovës.

9. OBJEKTIVAT E POLITIKAVE

Këto janë objektivat kryesore të politikave që adresojnë shqetësimet e ngritura përgjatë këtij dokumenti:

- Të gjendet ballanci i duhur që në njërin anë garanton sigurinë kombëtare e në anën tjetër mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
 - Garantimi i të drejtës së intimitetit;

⁷⁴ Intervista A, 2011, Prishtinë.

⁷⁵ Intervista B, 2011, Prishtinë.

⁷⁶ Rep. e Kosovës, ART, 2011, fq.6

⁷⁷ PC-World, 2010

- Përkrahja e sigurisë shtetërore dhe publike në një mjedis me një prani të madhe të aktorëve të sigurisë;
- Të përmirësohet bashkëpunimi në mes të Institucioneve të ndryshme të Drejtësisë dhe Sigurisë përbrenda sektorit vendor të sigurisë dhe në mes të aktorëve vendor dhe ndërkombëtar;
- Të përmirësohen mekanizmat e mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm, kontrollit demokratik, dhe atij të pavarur;
- Të avancohen rregulloret relevante të aktiviteteve të operatorëve të telekomunikacionit në fushën e bashkëpunimit me IDS-të dhe me atë të mbajtjes dhe mbrojtës së të dhënave të konsumatorëve.

10. REKOMANDIMET E POLITIKAVE

Këto janë rekomandimet e politikave për institucionet relevante të Republikës së Kosovës në disa nivele:

Legjislacioni

1. Të përmirësohet Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, ligji i telekomunikacionit, dhe të gjitha ligjet që do të vijnë e që kanë të bëjnë me çështjen e përgjimit ligjor të telekomunikimeve, ashtu që të jepen definicione apo të përcaktohen dhe dallohen këto:
 - Përgjimi i telekomunikimeve, i cili do të duhej ti referohet *përmbajtjes së komunikimeve*, direkte apo të incizuara;
 - Të dhënat mbi trafikun, të dhënat mbi lokacionin, dhe të dhënat personale, që do të duheshin ti referoheshin të *dhënave statike* të marra nga operatorët e telekomunikacionit nga format e ndryshme të përdorimit të shërbimeve nga ana konsumatorëve të këtyre shërbimeve;
 - Mbajtja e të dhënave, e cila do të duhej t'i referohej kushteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave.

Këto dallime janë shumë të rëndësishme në menaxhimin dhe kufizimet të cilat i vendosen masës së përgjimit ligjor të telekomunikimeve në mënyrë që të mbrohet e drejta e intimitetit. P.sh. do të duhej të ishte shumë më lehtë për IDS-të që të i qasen të dhënave statike (të dhënat e trafikut, lokacionit, dhe ato personale), dhe do të duhej të ketë më shumë limite kur vije puna të qasja në përmbajtje (komunikimit direkt apo të incizuar);
2. Ligji relevant, i cili mund të jetë edhe projektligji momental, duhet të përmirësohet në atë mënyrë që të përfshijë predispozitat e detajuara për standardizimin e procedurave të bashkëpunimit ndërmjet të gjitha Institucioneve të Drejtësisë dhe Sigurisë (të autorizuar që të përgjojnë telekomunikimet) dhe të gjithë operatorët e licencuar nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit;
3. Të ipen afate kur operatorët e telekomunikacionit do të duheshin t'i përgjigjen urdhrat të lëshuara nga IDS-të relevante;

4. Duhet të ketë dënime dhe të merren masat e duhura në rastet kur operatorët e telekomunikacionit refuzojnë t'i binden urdhrat të lëshuara nga organet e autorizuar. Duhet të jetë një mekanizëm që funksionon në tri faza në këtë aspekt, ku dy vërejtjet e para për mungesë bashkëpunimi do të shoqëroheshin me dënime progresive monetare, ku dënimi i dytë është më i lartë se sa i pari. Faza e tretë për mungesë bashkëpunimi do të duhej të shoqërohej me një masë të dënueshme siç parashihet me KPPP për mos bashkëpunim me drejtësinë;
5. Legjislacioni relevant duhet të jap predispozitat të cilat do të lejonin që përgjimi ligjor i telekomunikimeve të jetë më elastik (fleksibil) në rastet kur kjo masë është e ndaluar sipas Nenit 257 të KPPP-së, duke u siguruar në vazhdimësi që të drejtat dhe liritë e njeriut të mbrohen.

Procedurat e përgjithshme

6. Dy mekanizma të bashkëpunimit në mes të Institucioneve të Drejtësisë dhe Sigurisë duhet të ekzistojnë. Së pari, duhet të bëhet një 'sistem i informimit qendror' online ku do të mund të qaseshin të gjitha IDS-të dhe i cili mekanizëm do të përdorej si pikë qendrore e cila do t'i sinjalizonte të gjitha IDS-të në rast se ndonjë përpjekje për përzjerje të përgjegjësve apo rasteve shihet se do të ndodh. Kjo do të ndihmonte në qartësimin e zotërimit të kësaj mase të hetimit. Së dyti, 'ekipi i përbashkët hetimor' duhet të përmirësohet në atë formë që të përfshijë të gjitha IDS-të;
7. Të përmirësohet mbikëqyrja demokratike e përgjimit ligjor të telekomunikimeve duke e zgjeruar përgjegjësinë e komisionit relevant parlamentar ekzistues ashtu që të inspektoj aktivitetet e IDS-ve dhe të operatorëve të telekomunikacionit. Ky komision do të duhej të mbikëqyrte të gjitha IDS-të (tani: Policinë e Kosovës, AKI-në, dhe EULEX-in), si dhe të gjithë operatorët e telekomunikacionit në Kosovë. Ky trup inspektues do të duhej të kishte imunitet të plotë për qasjen në ndërtesa dhe instrumentet e të gjithë pjesëmarrësve në procesin e përgjimit ligjor të telekomunikacionit dhe do të duhej të posedonte ekspertizën e duhur për të inspektuar këto aktivitete;
8. Mandati i Ombudspersonit do të duhej të zgjerohej për të përfshirë të gjitha IDS-të dhe të gjitha masat e tyre të hetimit dhe vëzhgimit, duke përfshirë përgjimin e telekomunikimeve;

Institucionet e Drejtësisë dhe Sigurisë

9. Të ekzekutohet përgjimi ligjor i telekomunikimeve përtej dy operatorëve telefonik mobil në Kosovë, si dhe të përmblidhë të gjitha shërbimet e telekomunikimit;
10. Të krijohet një komision ekspertësh për të shqyrtuar dhe propozuar një plan veprimi sa i përket ndryshimit të kodit shtetëror telefonik (marrëveshje me ndonjë shtet tjetër) duke shikuar kah shtete me të cilat marrëdhëniet janë më mirë të përcaktuara.

BIBLIOGRAFIA:

Intervistat

Intervista A. Ish zyrtar i lartë në operatorin e telekomunikacionit. 20 tetor 2011. Prishtinë

Intervista B: Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. 22 tetor 2011. Prishtinë

Intervista C: Punëtor në prokurorinë e UNMIK-ut. 22 tetor 2011. Prishtinë

Intervista D: Zyrtar i EULEX-it. 26 tetor 2011. Prishtina

Marmullaku, Rifat. Ish zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. 22 tetor 2011. Prishtinë

Lista e dokumenteve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 2008.

Republika e Kosovës. Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Nr. 03/L-063. 2008.

Republika e Kosovës. Ligji për Hetim Parlamentar, No. 03/L-176. 2010

Republika e Kosovës. Vendimi i ART-së, Nr. Prot. 015/B/11

Republika e Kosovës. Rregullorja e ART-së, Klas 01/1, Reg.Nr. 3. 2010

UNMIK. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. 2003.

UNSC. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit të Kosovës. 2007.

Burime tjera

Ekonomia. “E vërteta mbi SHIK-un kërkohet nga AKI-ja.” p.d. <http://www.ekonomia-ks.com/?page=1,5,5628>

Ekonomisti. “Sa përgjohemi?.” 22 gusht 2011. <http://www.ekonomisti.net/artikulli/4/0/20670/sa-pergjohemi/>

Elezi, Valmir. “Prishtinë, gjendet fëmija i rrëmbyer.” TV News Report. *Top-Channel*. 3 mars 2011. <http://www.balkanweb.com/notizia.php?IDNotizia=57231>

Haxha, Shyqri. “?Ipko?, bisedime me policinë për përgjimet.” *Kosova Sot*, 6 shtator 2010. <http://www.kosova-sot.info/ekonomi/ipko-bisedime-me-policine-per-pergjimet>

Haxhiu, Baton. “Me Merita Kostanica.” *Zona B. Klan Kosova*. 26 shtator 2010. <http://klankosova.tv/index.php/zona-b/5624-me-merita-kostanica.html>

Human Rights Review Panel. Qasur më 7 tetor 2011. <http://www.hrrp.eu/>

Kabashi, Ismet. “*Kabashi - Rexhepit, bëjë kallëzim penal, por ndërkombëtarët kanë imunitet.*” *Bota Sot*. 2011. <http://www.botasot.info/def.php?category=3&id=137001>

- Kajtazi, Vehbi. "Ministri Rexhepi thotë se është nën përgjim nga viti 2002." *Koha Ditore*. 14 shtator 2011.
- Kosova Sot. "Ipko?, bisedime me policinë për përgjimet." 6 shtator 2010. <http://www.kosova-sot.info/ekonomi/ipko-bisedime-me-policine-per-pergjimet>
- Kostanica, Merita. "Me Merita Kostanica." Zona B. Klan Kosova. 26 shtator 2010. <http://klankosova.tv/index.php/zona-b/5624-me-merita-kostanica.html>
- Mellon, Jerome. "Understanding Intelligence in a Kosovo Context." Safe World, maj (2007). <http://cv.jmellon.com/swgi.pdf>
- PC-World. "Operatorët e palicencuar dëmtojnë shitjen e Telekomit të Kosovës." 30 mars 2010. <http://www.pcworld.al/lajmet/1992-Operatort-palicencuar-dmtojn-shitjen-Telekomit-Kosovs.html>
- Peci, Lulzim and Dugolli, Ilir. "Intelligence Agencies of Kosovo: Dismantling, Osmosis, or Integration." Policy Brief Series: paper #2. *KIPRED*: Pishtinë, 2006.
- QKSS, et. al. "Raporti i Progresit: Made in Kosova." 10 tetor 2011. <http://qkss.org/new/images/content/PDF/raporti-shabllon-design-shqip.pdf>
- Republic of Kosovo, TRA, Pasqyrë e Tregut të Telekomunikacionit, K4-2010, Prishtinë, prill 2011. <http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20telekomunikacionit%20K4%20-%202010.pdf>
- Spiegel Online International. "Spy Scandal: German Intelligence Officers Detained in Kosovo" 24 nëntor 2008. <http://www.spiegel.de/international/europe/0,1518,592298,00.html>
- Thorogood, Rupert and Brookson, Charles. "Lawful Interception" 2007. *Teletronikk*, shkurt (2007) http://www.teletronikk.com/volumes/pdf/2.2007/Page_033-036.pdf

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)
Rr. Qamil Hoxha, 2-2
Prishtinë 10000
Kosova

Email: info@qkss.org
Web: www.qkss.org
Tel.Fax: +381 38 221 420